



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI		
Nr. / Br. / No. <u>2012</u>	Nr. i faq/ Br. str / No. pg <u>1</u>	
Data / Datum / Data: <u>03.08.2023</u>		Pejë / Paç

Këshilli Drejtues

Datë: 03.08.2023

Në bazë të nenit 17 dhe nenit 23 të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka " Pejë, Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me 28.07.2023, morri këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** Rregullorja për Rregullat dhe Procedurat për Zgjedhjet e Përgjithshme të Personelit Akademik dhe Jo Akademik në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë.
- II. Këtij vendimi i bashkëngjitet Rregullorja për Rregullat dhe Procedurat për Zgjedhjet e Përgjithshme të Personelit Akademik dhe Jo Akademik në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë.
- III. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Kryesuese e Këshillit Drejtues të UHZ-së
Prof. Ass. Dr. Majlinda Belegu



Vendimi t'i dërgohet: Kryesueses së KD-së, Anëtarëve të KD-së, Rektorit, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Kryesuesit për Teknologji të Informacionit, Arkivës së UHZ-së.



	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË	UNIVERSITETI UNIVERSITET "HAXHI ZEKA" PEJE	
REKTORATI			
Nr. / Br. / No. <u>2012</u>		Nr. i faq/ Br. str/ No. pg <u>19</u>	
Data / Datum / Date: <u>03.08.2023</u> Pejë / Peć			

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

RREGULLORE

**PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT PËR ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME TË PERSONELIT
AKADEMIK DHE JO AKADEMIK NË UNIVERSITETIN "HAXHI ZEKA" NË PEJË**

Përmbajtja

Qëllimi dhe fushëveprimi i rregullores	3
Dispozitat e përgjithshme dhe shkurtesat	3
Organet për të cilat mbahen zgjedhjet	3
Personeli që ka të drejtë të marrë pjesë në zgjedhje	4
Mandatet e fituara nga zgjedhjet në UHZ.....	4
Kufizimet në të drejtën e zgjedhjes	5
Rregullat, procedurat zgjedhore dhe përbërja e Këshillave të Fakulteteve	6
Verifikimi i mandateve të anëtarëve të Këshillit të Fakultetit.....	8
Zgjedhjet për Senat, personelin akademik dhe jo akademik	8
Kandidimi për Këshillin e Fakultetit dhe për Senat	10
Zgjedhja e kryesuesit të përkohshëm të Këshillit të Fakultetit dhe përfaqësuesit të përkohshëm-Dekan në Senat	10
Nominimi i kandidatëve për pozitën e Dekanit.....	112
Listat e votuesve	12
Përmbajtja e listës së votuesve	124
Regjistrimi i kandidatëve për Këshill dhe Senat	125
Përmbajtja e listës së kandidatëve	13
Komisioni Qendror Zgjedhor-KQZ.....	14
Ankesat.....	15
Komisioni Zgjedhor i Fakultetit	156
Data e zgjedhjeve të përgjithshme	16
Mënyra e votimit.....	167
Mbikëqyrja e procesit zgjedhor	16
Procedurat e votimit dhe fletëvotimet.....	168
Rijedha e procedurës zgjedhore dhe të votimit	179
Fletëvotimi dhe vlefshmëria.....	17
Rezultatet e zgjedhjeve dhe hedhja e shortit	18
Periudha e ankesave pas shpalljes së rezultateve	18
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE	189
Vlefshmëria dhe zbatimi.....	18
Shfuqizimi.....	20
Hyrja në fuqi.....	20

Në mbështetje të Statutit, si dhe në pajtim me Ligjin nr.04/L-037 për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës, Këshilli Drejtues i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, në mbledhjen e mbajtur me datë 28.07.2023, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT PËR ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME TË PERSONELIT AKADEMIK DHE JO AKADEMIK NË UNIVERSITETIN E "HAXHI ZEKA" NË PEJË

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi i rregullores

1. Kjo rregullore ka për qëllim rregullimin e mënyrës së organizimit të zgjedhjeve në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë si dhe procedurat zgjedhore në kuadër të këtyre zgjedhjeve.
2. Kjo rregullore zbatohet vetëm për zgjedhjet në organet e UHZ-së.

Neni 2

Dispozitat e përgjithshme dhe shkurtesat

1. Të gjitha rregullat dhe procedurat zgjedhore, siç përcaktohen me këtë rregullore, bazohen në Statutin e UHZ-së si dhe legjislacionin në fuqi i cili është relevant përkitazi me çështjet që rregullon kjo rregullore.
2. Secila palë e pakënaqur lidhur me procedurat zgjedhore ka të drejtë ankese kundër vendimeve të nxjerra në kuptim të kësaj rregulloreje. Instancë e parë për shqyrtimin e ankesave është Komisioni Zgjedhor i Fakultetit.
3. Ankesa kundër vendimit të Komisionit Zgjedhor të Fakultetit, i parashtrohet Komisionit Qendror Zgjedhor. Vendimi i KQZ-së është përfundimtar.
4. Shkurtesat e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin si në vijim:
 - 4.1 UHZ-Universitetit "Haxhi Zeka";
 - 4.2 KQZ-Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;
 - 4.3 KZF-Komisioni Zgjedhor i Fakultetit;
 - 4.4 KF-Këshilli i Fakultetit.

Neni 3

Organet për të cilat mbahen zgjedhjet

1. Zgjedhjet organizohen në të gjitha njësitë akademike për kategoritë si në vijim:
 - 2.1. Anëtarët e këshillave të fakulteteve nga radhët e profesorëve;
 - 2.2. Anëtarët e këshillave të fakulteteve nga radhët e asistentëve;
 - 2.3. Anëtarin e këshillave të fakulteteve nga radhët e personelit jo-akademik;

- 2.4. Anëtarin e Senatit nga radhët e personelit akademik i secilës njësi akademike;
 - 2.5. Anëtarët e Senatit nga radhët e personelit jo – akademik;
2. Zgjedhjet për anëtarë të Senatit nga radhët e personelit jo-akademik do të mbahen edhe në Administratën Qendrore të UHZ-së.

Neni 4

Personeli që ka të drejtë të marrë pjesë në zgjedhje

1. Në zgjedhjet të cilat zhvillohen në kategoritë e përcaktuara në nenin 3 të kësaj rregulloreje kanë të drejtë të kandidohen i gjithë personeli i zgjedhur në marrëdhënie të rregullt të punës. Personeli akademik, në kuptim të këtij paragrafi përfshin kategoritë e përcaktuara si në vijim:
 - 1.1. Profesor i rregullt;
 - 1.2. Profesor i asocuar;
 - 1.3. Profesor asistent;
 - 1.4. Asistent universiteti;
 - 1.5. Lektorët dhe korepetitorët (Fakulteti i Arteve)..
2. Personel akademik, konsiderohen të gjithë ata/ato të cilët kanë fituar thirrjen përkatëse akademike nga Senati i UHZ-së, duke pasur parasysh ditën e votimit në Senat.
3. Përrjashtimisht nga paragrafi 2 i këtij neni bëhet për personelin e zgjedhur për herë të parë në UHZ, dhe që nuk mund të pajisen me kontratë të rregullt pune deri në një afat të caktuar (fillimi i semestrit dimëror ose veror). Kjo kategori e personelit që pritet të themeloj marrëdhënie të rregullt pune në afatin e përcaktuar siç parashihet në këtë paragraf, nuk kanë të drejtë të kandidohen, të zgjedhën dhe as të votojnë në zgjedhjet të cilat mbahen sipas kësaj rregulloreje.
4. Kriteret e njëjta të parapara në paragrafin 3 të këtij neni, zbatohen edhe ndaj personelit administrativ i cili deri në momentin e regjistrimit për pjesëmarrje në zgjedhje nuk është i pajisur me akt emërim/themelim të marrëdhënies së rregullt të punës.

Neni 5

Mandatet e fituara nga zgjedhjet në UHZ

1. Të gjithë ata të cilët fitojnë mandat dhe përfaqësohen në organet përkatëse brenda UHZ-së, nga zgjedhjet e mbajtura sipas kësaj rregulloreje, e mbajnë mandatin e tyre bazuar në Statutin e UHZ-së.
2. Në rast të dorëheqjes, ndërprerjes së kontratës/humbjes së statusit të personelit akademik, pensionimit, vdekjes, marrjes së mandatit apo humbja e mandatit për

shkak të ndonjë arsyeje tjetër, mandati do t'i takojë personit të parë në listën e pritjes sipas regjistrit të rezultatit të zgjedhjeve. Ky paragraf vlen vetëm për anëtarët e Këshillave të Fakulteteve.

3. Në rastet kur nuk ka persona në dispozicion nga rezultatet e zgjedhjeve si në paragrafin 2 të këtij neni, njësia akademike përkatëse, do të mbajë zgjedhjet për plotësimin e mandateve vakante sipas procedurave të njëjta të përcaktuara në këtë rregullore, më së largu 10 ditë pas mbetjes vakante të pozitës.

Neni 6

Kufizimet në të drejtën e zgjedhjes

1. Sipas Statutit, personeli në marrëdhënie të rregullt pune, i cili është i zgjedhur apo emëruar në ndonjë institucion tjetër publik, nuk ka të drejtë për t'u zgjedhur në organe drejtuese, por ka të drejtë për të votuar për kategoritë e përcaktuara në këtë rregullore.
2. Personeli akademik i zgjedhur apo emëruar në një funksion tjetër publik në kuptim të paragrafit 1 të këtij neni, nënkupton zgjedhjen apo emërimin si në vijim: President i Republikës së Kosovës; Deputet në Kuvendin e Kosovës; Anëtarë i Qeverisë së Republikës së Kosovës; Anëtar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës; Funkionarët e emëruar nga Kuvendi, Presidenti i Republikës dhe fitullarët apo anëtarët e organeve drejtuese kolegjiale të institucioneve të pavarura dhe të agjencive të pavarura; Funkionarët e emëruar nga Presidenti; Anëtarët e Këshillit Prokurorial të Kosovës apo funksionet e tjera në sistemin e drejtësisë; Sekretarët e Përgjithshëm në Ministri; Kryeshefat e Agjencive të Pavarura.
3. Përjashtim nga kategoria e përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, bëjnë i gjithë personeli akademik të cilët ofrojnë këshilla për institucione publike, si këshilltar, konsulent apo janë anëtarë të komisioneve profesionale dhe grupeve të ndryshme të ekspertëve.
4. Anëtarët e këshillave të fakulteteve nga radhët e personelit jo-akademik nuk mund të zgjedhën anëtarë të Senatit.
5. Anëtarët e Senatit të UHZ-së nuk kanë të drejtë të zgjedhën për më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme. Llogaritja e mandateve në kuptim të këtij paragrafi behet duke marrë parasysh edhe mandatet e kaluara, përshtatshëmrisht me dispozitat që kufizojnë mandatet për të gjitha organet tjera të UHZ-së.
6. Me qëllim të shmangies së konfliktit eventual të interesit, të drejtë për tu zgjedhur në organet drejtuese, sipas këtij neni nuk kanë të gjithë ata që përfaqësojnë dhe mbrojnë UHZ-në në organet administrative dhe gjyqësore, në të cilat organe vendimet e UHZ-së mund të kontestohen nga palët e pakënaqura.

7. Organe drejtuese në kuptim të paragrafit 1 të këtij neni përfshijnë përfaqësimin në organet si në vijim: Këshillit Drejtues, Senatit, Rektor, Prorektor, Dekan, Prodekan.
8. Për pozitat Prodekan; Dekan; Prorektor; Rektor; Anëtar i Senatit dhe Anëtar i Këshillit të Fakultetit nuk mund të zgjedhën anëtarët e Këshillit Drejtues, të cilët janë nën mandat të rregullt, përveç nëse paraprakisht japin dorëheqje. Në rast të dorëheqjes së anëtarit të Këshillit Drejtues, Senati i UHZ-së i cili është në mandat, zgjedh anëtarin e ri të Këshillit Drejtues.
9. Për pozitat Dekan ose Rektor, nuk mund të zgjedhën kandidatët të cilët pengohen që ta ushtrojnë së paku gjysmën e mandatit për shkak të plotësimin të moshës mandatore të pensionit.
10. Në rastet e kontestueshme, në lidhje me të drejtën për të votuar ose të drejtën për kandidim, vendimi mund të ankimohet në Komisionin Qendror Zgjedhor.
11. Lidhur me ankesën e ushtruar sipas nenit 2 të kësaj rregulloreje, Komisioni Qendror Zgjedhor, nxjerr vendim në formë të shkruar dhe duhet ta arsyetoj siç parashihet me dispozitat përkatëse të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Vendimi i KQZ-së është përfundimtar.

Neni 7

Rregullat, procedurat zgjedhore dhe përbërja e Këshillave të Fakulteteve

1. Çdo fakultet ka këshillin. Anëtarët e këshillit janë:
 - 1.1. Dekani;
 - 1.2. Prodekanët;
 - 1.3. Sekretari i Fakultetit, pa të drejtë vote;
 - 1.4. Deri në 15 anëtarë të zgjedhur nga radhët e profesorëve të fakultetit;
 - 1.5. Deri në 2 anëtarë të zgjedhur nga radha e asistentëve të fakultetit;
 - 1.6. Një anëtar i zgjedhur nga personeli jo akademik i fakultetit;
 - 1.7. Një përfaqësues të studentëve të zgjedhur nga Këshilli i Studentëve të Fakultetit.
2. Anëtarë të Këshillit të Fakultetit zgjedhën deri 15 profesorë të cilët kanë thirrjen akademike profesor i rregullt, profesor i asocuar, profesor asistent, me kusht që thirrjen akademike ta kenë fituar nga Senati i UHZ-së, para shpalljes së zgjedhjeve sipas kësaj rregulloreje.
3. Në fakultetet ku numri i përgjithshëm i profesorëve, siç përcaktohet në paragrafin 2 të këtij neni nuk e kalon numrin 15, të gjithë profesorët të cilët regjistrohen për të fituar mandatin në Këshillin e fakultetit, mandatohen automatikisht si anëtarë të Këshillit të fakultetit.

4. Anëtarët e këshillit të fakultetit nga radhët e asistentëve zgjedhën nga personeli akademik me thirrjen akademike asistent i fakultetit siç përcaktohet në këtë rregullore.
5. Numri i asistentëve të zgjedhur në këshillin e fakultetit është më së shumti 2 (dy) anëtarë.
6. Në fakultetet ku numri i përgjithshëm i asistentëve, siç përcaktohet në paragrafin 5 të këtij neni, nuk e kalon numrin dy (2), të gjithë asistentët që regjistrohen për të fituar mandatin si anëtar të këshillit të fakultetit, mandatohen automatikisht anëtar të këtij këshilli.
7. Pavarësisht dispozitave të tjera të kësaj rregulloreje, anëtari i këshillit të fakultetit, i cili fiton mandatin si anëtar i këtij organi dhe ndërkohë emërohet dekan ose prodekan i fakultetit përkatës, mandati i fituar tij/saj nuk zëvendësohet me anëtarët e rinjë. Në rast së ndërprerjes së mandatit mund të kthehet si anëtar i këshillit të fakultetit.
8. Për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Fakultetit nga radhët e profesorëve (profesor i rregullt, profesor i asocuar dhe profesor asistent), të drejtë vote kanë të gjithë profesorët që janë në marrëdhënie të rregullt pune në fakultet, sipas kësaj rregulloreje.
9. Për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Fakultetit nga radhët e asistentëve, të drejtë vote kanë të gjithë asistentët që janë në marrëdhënie të rregullt pune në fakultet, sipas kësaj rregulloreje.
10. Për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit të Fakultetit nga radhët e personelit jo akademik, të drejtë vote kanë i tërë personeli jo akademik në marrëdhënie të rregullt pune në fakultet.
11. Një përfaqësues nga radha e studentëve në Këshillin e Fakultetit, zgjedhën sipas propozimit të Këshillit të Studentëve të Fakultetit në pajtim me dispozitat e Rregullores mbi zgjedhjet e studentëve dhe Punën e Parlamentit dhe Këshillave të Studentëve.
12. Në rast të dorëheqjes, ndërprerjes së kontratës/humbjes së statutit të personelit akademik/administrativ, pensionimit, vdekjes, marrjes së mandatit apo humbja e mandatit për shkak të ndonjë arsyeje tjetër, mandati do t'i takojë personit të parë në listën e pritjes sipas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve. Zëvendësimi i vendit vakant bëhet sipas kategorisë së njëjtë sipas listës së certifikuar para mbajtjes së zgjedhjeve,
 - 12.1. Anëtarët e këshillave të fakulteteve nga radhët e profesorëve zëvendësohen nga lista e profesorëve;

- 12.2. Anëtarët e këshillave të fakulteteve nga radhët e asistentëve zëvendësohen nga lista e asistentëve;
 - 12.3. Anëtarët e këshillave të fakulteteve nga radhët e personelit jo-akademik zëvendësohen nga lista e personelit jo – akademik.
13. Në rast se nuk ka persona në listën e çertifikuar nga zgjedhjet e fundit sipas paragrafit 2 dhe 3 të këtij neni, fakulteti përkatës, do të mbajë zgjedhjet për plotësimin e mandateve vakante sipas procedurave të njëjta të përcaktuara në këtë rregullore për mandatin e mbetur, jo më larg se 10 ditë pas mbetjes vakante të pozitës, dhe me afate të përgjysmuara.
 14. Personat të cilët kanë dhënë dorëheqje, apo i është marrë/humbë mandatin, në zgjedhjet për plotësimin e vendeve vakante nuk kanë të drejtë të zgjedhen vetëm të zgjedhin, më përjashtim të stafit që kanë humb mandatin sipas paragrafit 2 të këtij neni.
 15. Të drejtë kandidimi në zgjedhjet për plotësimin e vendeve vakant kanë vetëm personat të cilët nuk kanë marr pjesë në procesin e zgjedhjeve të fundit.
 16. Sekretari i Fakultetit është anëtar i Këshillit të Fakultetit sipas detyrës zyrtare, pa të drejtë vote dhe është përgjegjës për ligjshmërinë e punës së Këshillit të Fakultetit.

Neni 8

Verifikimi i mandateve të anëtarëve të Këshillit të Fakultetit

1. Këshilli i Fakultetit në mbledhjen e parë të tij përmes sekretarit të fakultetit bënë verifikimin e mandateve të anëtarëve të këshillit të fakultetit (përmes letërnjoftimi dhe vendimit për fitimin e mandatit), në bazë të raportit për rregulsinë e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të Fakultetit.
2. Pas verifikimit të mandatit nga sekretari i fakultetit, anëtarët e Këshillit të Fakultetit e nënshkruajnë deklaratën etike si vijon: *"Deklaroj se do t'i kryej detyrat me nder dhe me besnikëri, me drejtësi dhe pa anim, me ndërgjegje dhe përgjegjësi, se do t'i përfaqësoj me ndërgjegje dhe përkushtim interesat e Fakultetit dhe të Universitetit në përgjithësi, si dhe do t'i përmbahem Statutit të Universitetit dhe legjislacionit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës"*.

Neni 9

Zgjedhjet për Senat, personelin akademik dhe jo akademik

1. Një anëtar i personelit akademik nga secili Fakultet zgjedhet anëtar i Senatit.
2. Përfaqësuesi i fakultetit në Senat do të zgjedhet nga personeli akademik i secilit Fakultet siç përcaktohet në Statut.
3. Përfaqësuesi i fakultetit në Senatën e UHZ-së, zgjedhet me shumicën absolute të votave të të gjithë personelit akademik që marrin pjesë në votim.
4. Për zgjedhjen e përfaqësuesit të Fakultetit në Senat, të drejtë vote ka i tërë personeli akademik në marrëdhënie të rregullt pune në fakultet, në pajtim me

dispozitat e kësaj rregulloreje.

5. Një përfaqësues i stafit jo akademik në Senat zgjedhën me shumicën absolute të votave të të gjithë atyre që marrin pjesë në votim, nga radhët e personelit jo akademik në marrëdhënie të rregullt pune në të gjitha njësitë akademike dhe në administratën qendrore të UHZ-së.
6. Për zgjedhjen e përfaqësuesve të stafit jo akademik, të drejtë vote ka i gjithë personeli jo akademik në marrëdhënie të rregullt pune në UHZ-së.
7. Nëse asnjë nga kandidatët për Senat nga personeli akademik dhe jo akademik nuk e marrin shumicën absolute të votave të personelit akademik, respektivisht jo-akademik që marrin pjesë në votim, atëherë organizohet rasti i dytë i votimit për dy kandidatët për personelin akademik, respektivisht katër kandidatë për personelin jo akademik, të cilët kanë më së shumti vota në raundin e parë. Konsiderohet i zgjedhur kandidati/ja që fiton shumicën e votave në raundin e dytë, përkatësisht një kandidatët që fitojnë më së shumti vota në këtë raund nga radhët e personelit jo akademik.
8. Raundi i dytë për zgjedhjen e anëtarëve të Senatit nga personeli akademik dhe jo akademik mbahet më së largu dy (2) ditë pune nga dita e përfundimit të raundit të parë.
9. Në rast se ka dy ose më shumë kandidatë me vota të barabarta në raundin e dytë, përzgjedhja e kandidatëve bëhet në praninë e kandidatëve, përmes hedhjes së shortit. Shorti hidhet nga KQZ.
10. Votimi për anëtar të Senatit nga personeli akademik dhe jo akademik bëhet në atë mënyrë që të gjithë kandidatët renditen në fletëvotim, në bazë të alfabetit. Të gjithë ata që marrin pjesë në votim, kanë të drejtë të votojnë vetëm një kandidat për anëtar të Senatit, respektivisht një kandidatë nga radhët e personelit jo akademik.
11. Sekretari i përgjithshëm i universitetit është anëtar ex-officio i Senatit pa të drejtë vote dhe është përgjegjës për ligjshmërinë e punës së Senatit.
12. Në rast të dorëheqjes, ndërprerjes së kontratës, pensionimit, vdekjes, apo në çfarëdo rasti të mbetjes vakante të mandatit të përfaqësuesit të fakultetit në Senat nga radhët e personelit akademik apo jo akademik, njësia akademike përkatëse, përkatësisht njësitë akademike dhe administrata qendrore e UHZ-së (në rastin e përfaqësuesit në Senat të personelit jo-akademik) mbajnë zgjedhjet për zgjedhjen e anëtarit të ri të Senatit, sipas procedurave të njëjta të përcaktuara në këtë rregullore, më së largu 10 ditë pas mbetjes vakante të pozitës.

Neni 10

Kandidimi për Këshillin e Fakultetit dhe për Senat

1. Anëtar i personelit akademik dhe jo akademik, ka të drejtë të regjistrohet si kandidat për mandatin e caktuar sipas dispozitave të kësaj rregulloreje dhe Statutit.
2. Anëtarët e KQZ-së dhe KZF-së, mund të kandidojnë në zgjedhjet e përgjithshme të UHZ-së, vetëm në nivel të Këshillit të Fakultetit, por jo edhe në pozita menaxhuese dhe qeverisëse të Universitetit (Dekan, Senator apo Rektor).
3. Të gjithë kandidatët e interesuar kanë të drejtë të regjistrohen për të fituar më shumë se një mandat, sipas kësaj rregulloreje.
4. Në qoftë se një anëtar i personelit zgjedhet në më shumë se një organ në UHZ-së, kandidati para se të filloj ushtrimin e mandatit, përcaktohet se në cilin organ do ta ushtrojë mandatin e tij/saj, në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje.

Neni 11

Zgjedhja e kryesuesit të përkohshëm të Këshillit të Fakultetit dhe përfaqësuesit të përkohshëm-Dekan në Senat

1. Kryesuesi i përkohshëm i Këshillit të Fakultetit zgjedhet nga kandidatët e propozuar të Këshillit të Fakultetit, me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit të Fakultetit, në seancën e parë të verifikimit të mandateve të anëtarëve të Këshillit të Fakultetit.
2. Nëse asnjë nga kandidatët e propozuar për kryesues të përkohshëm të KF-së, nuk e merr shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve, atëherë organizohet rasti i dytë i votimit, vetëm për kandidatin me numër më të madh të votave. Nëse kandidati nuk merr shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve, në radhën e dytë, konsiderohet se kandidati është refuzuar dhe Këshilli i Fakultetit është i obliguar të propozoj kandidat tjetër.
3. Në rast të votave të barabarta mes kandidatëve të propozuar, votimi përsëritet.
4. Kryesuesi i përkohshëm i KF-së, është edhe përfaqësues i dekanit të Fakultetit në Senat deri në zgjedhjen e dekanit.
5. Votimi bëhet në atë mënyrë që të gjithë kandidatët vendosen në një fletëvotim sipas alfabetit dhe të gjithë ata që marrin pjesë në votim, kanë të drejtë të votojnë vetëm për një kandidat.

Neni 12
Nominimi i kandidatëve për pozitën e Dekanit

1. Çdo anëtar i Këshillit të Fakultetit ka të drejtë të propozojë një kandidat/e për pozitën e Dekanit.
2. Propozimet për kandidatët për Dekan duhet të jenë të arsyetuara mirë dhe të përfshijnë edhe një biografi të shkurtë të kandidatit/es.
3. Të gjithë kandidatët e propozuar për Dekan përfshihen në fletëvotim dhe radhiten sipas alfabetit me emër dhe mbiemër. Anëtar i Këshillit të Fakultetit ka të drejtë të votojë në fletëvotim vetëm një (1) kandidat për pozitën e Dekanit, përmes votimit të fshehtë. Kandidati i cili merr shumicën absolute të votave të të gjithë anëtarëve të Këshillit konsiderohet i zgjedhur në këtë pozitë dhe i propozohet Senatit për miratim.
4. Nëse asnjë kandidat nuk e arrin shumicën absolute të votave të të gjithë anëtarëve të Këshillit të Fakultetit në raundin e parë, mbahet raundi i dytë. Edhe në raundin e dytë kandidati/ja i cili merr shumicën absolute e votave të të gjithë anëtarëve të Këshillit konsiderohet i zgjedhur në këtë pozitë dhe i propozohet Senatit për miratim.
5. Nëse asnjëri prej kandidatëve nuk arrin shumicën absolute të votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit të Fakultetit në raundin e parë dhe të dytë, dy kandidatët më të votuar kalojnë në raundin e tretë. Në raundin e tretë, kandidati/ja për Dekan që fiton më së shumti vota, të të gjithë atyre që votojnë konsiderohet i zgjedhur në këtë pozitë dhe i propozohet Senatit për miratim.
6. Në rast të votave të barabarta në raundin e tretë apo dështimit për çfarëdo arsye tjetër të zgjedhjes së Dekanit, atëherë procedura përsëritet nga fillimi. Votimi i radhës duhet të mbahet jo më vonë se 24 orë nga dita e mbledhjes kur është bërë votimi i parë.
7. Në rast se për zgjedhje në pozitën e Dekanit nuk ka më shumë se një kandidat, procedura për zgjedhjen e Dekanit zhvillohet në të tre raundet, nëse ai/ajo nuk e merr shumicën e nevojshme në raundin e parë dhe të dytë.
8. Procedura e votimit për zgjedhjen e Dekanit zhvillohet pa ndërprerje dhe brenda të njëjtës ditë dhe të njëjtës mbledhje të Këshillit të Fakultetit, në kuadër të së cilës është caktuar si pikë e rendit të ditës, me përjashtim të rastit të përcaktuar në paragrafin 6 të këtij neni.

Neni 13
Listat e votuesve

1. MBNJ-ja në Administratën Qendrore e UHZ-së, ka për detyrë t'i ofrojë Komisionit Qendror Zgjedhor të dhënat e kompletuara të personelit me të drejtë vote, duke pasur parasysh kufizimet në këtë rregullore.
2. Në rast të vonesës ose refuzimit për të dorëzuar të dhënat nga ndonjë Fakultet, ndaj personave përgjegjës do të iniciohet procedura disiplinore nga ana e Këshillit Drejtues të UHZ-së, pas njoftimit nga ana e Komisionit Qendror Zgjedhor.

Neni 14
Përmbajtja e listës së votuesve

1. Lista e personelit akademik dhe jo akademik me të drejtë vote për Fakultet do të përgatitet nga Komisioni Qendror Zgjedhore.
2. Lista e personelit të administratës qendrore me të drejtë vote do të përgatitet nga KQZ.
3. Listat e personelit me të drejtë vote, do të përfshijnë të dhënat në vijim:
 - 3.1. Për personelin akademik:
 - 3.1.1. Numri rendor;
 - 3.1.2. Emri dhe mbiemri;
 - 3.1.3. Data muaji dhe viti i lindjes;
 - 3.1.4. Thirrja akademike;
 - 3.1.5. Fakulteti.
 - 3.2. Për personelin jo – akademik:
 - 3.2.1. Numri rendor;
 - 3.2.2. Emri dhe mbiemri;
 - 3.2.3. Data, muaji dhe viti i lindjes;
 - 3.2.4. Pozita;
 - 3.2.5. Fakulteti /Administrata qendrore.

Neni 15
Regjistrimi i kandidatëve për Këshill dhe Senat

1. Çdo anëtarë i personelit akademik apo jo akademik ka të drejtë të kandidohet për anëtar të Këshillit të Fakultetit dhe anëtar të Senatit, përveç rasteve të parapara në nenin 6 të kësaj rregulloreje dhe kufizimet tjera.
2. Procedurat e regjistrimit përgatiten për secilin Fakultet.
3. Regjistrimi i kandidatëve bëhet në ditën e përcaktuar nga KQZ, prej orës 08:00-14:00.
4. Dita e regjistrimit duhet të jetë së paku 3 ditë para ditës së zgjedhjeve.

5. Personeli akademik dhe jo akademik që për arsye të caktuara e kanë të pamundur pjesëmarrjen fizike për regjistrim të kandidaturës, duhet t'iu jepet mundësia që të regjistrohen përmes aplikacioneve të shkruara-elektronike.
6. Një formular përkatës për regjistrim, sipas shtojcës 1 të kësaj rregulloreje, do të jetë në dispozicion në Rektorat dhe në web faqen zyrtare të UHZ-së. Pas plotësimit, formulari dorëzohet në e-mailin e KQZ-së.

Neni 16 **Përmbajtja e listës së kandidatëve**

1. Lista e kandidatëve të Fakultetit për anëtarë të Këshillit të Fakultetit, Dekan dhe anëtarë të Senatit do të përgatitet nga KQZ.
2. Komisioni Qendror Zgjedhor është i obliguar të kontrollojë çdo regjistrim të kandidaturës për sa i përket vlefshmërisë, duke iu referuar listës së votuesve dhe dispozitave të këtyre rregullave dhe procedurave të përcaktuara në këtë rregullore.
3. Lista e kandidaturave të administratës qendrore për Senat do të përgatitet poashtu nga KQZ.
4. Listat zyrtare të kandidatëve do të verifikohen dhe miratohen nga Komisioni Qendror Zgjedhor për secilin Fakultet dhe administratën qendrore, duke përfshirë të dhënat në vijim:
 - 4.1. Për personelin akademik:
 - 4.1.1. Numri rendor;
 - 4.1.2. Emrin dhe mbiemrin;
 - 4.1.3. Data, muaji dhe viti i lindjes;
 - 4.1.4. Numri personal;
 - 4.1.5. Thirrja akademike;
 - 4.1.6. Fakulteti.
 - 4.2. Për personelin jo-akademik:
 - 4.2.1. Numri rendor
 - 4.2.2. Emri dhe mbiemri;
 - 4.2.3. Data, muaji dhe viti i lindjes;
 - 4.2.4. Numri personal;
 - 4.2.5. Pozita;
 - 4.2.6. Fakulteti/ Administrata qendrore.
5. Lista zyrtare e personelit që kandidohen, së paku një (1) ditë para zgjedhjeve do të publikohet nga Komisioni Qendror Zgjedhor në dekanatet e Fakulteteve dhe në ëeb faqen e njësive akademike dhe atë të UHZ-së.

Neni 17
Komisioni Qendror Zgjedhor-KQZ

1. Komisioni Qendror Zgjedhor do të përmbushë obligimet e veta, sipas Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë, Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" dhe rregulloreve në fuqi.
2. Komisioni Qendror Zgjedhor emërohet nga Këshilli Drejtues, me rastin e shpalljes së zgjedhjeve.
3. KQZ është përgjegjës për organizimin dhe mbikëqyrjen e zgjedhjeve të përgjithshme të UHZ-së.
4. KQZ, përbëhet nga tre (3) profesor, një (1) asistentë në marrëdhënie të rregullt pune, dhe Sekretari i Përgjithshëm i UHZ-së. Kryesuesi i KQZ-së, duhet të jetë Sekretari i Përgjithshëm i UHZ-së, zëvendës kryesuesi dhe sekretari i KQZ-së, zgjedhen nga anëtarët tjerë në mbledhjen e parë.
5. Në cilësinë e vëzhguesit, pjesë e KQZ-së është edhe një person nga KQZ e Republikës së Kosovës.
6. Anëtarë të KQZ-së nuk mund të jenë: Rektori, Prorektorët, Dekanët, Prodekanët, Anëtarët e Senatit, Anëtarët e Këshillit Drejtues.
7. Përgjegjësitë e KQZ-së janë:
 - 7.1. përcaktimi dhe zbatimimi i dinamikës së zgjedhjeve;
 - 7.2. përgatitja e listave për zgjedhje;
 - 7.3. nxjerrja e vendimeve rreth kundërshtimeve kundër listës së zgjedhjeve;
 - 7.4. certifikimi i kandidaturave në zgjedhje;
 - 7.5. konstatimi i numrit të përgjithshëm të mandateve;
 - 7.6. vlerësimi i listës së kandidatëve;
 - 7.7. kryesimi i procedurave zgjedhore;
 - 7.8. identifikimi i listave përfundimtare të atyre që kanë të drejtë vote;
 - 7.9. konstatimi i rezultateve të zgjedhjeve;
 - 7.10. shpallja e rezultateve të zgjedhjeve;
 - 7.11. certifikimi i mandateve;
 - 7.12. zëvendësimi i mandatit;
 - 7.13. koordinimi i komisioneve zgjedhore të Fakulteteve për konstituimin e Këshillave të Fakulteteve.
8. Për të gjitha rastet kur mandati në organet e UHZ-së, për personat e zgjedhur sipas kësaj rregulloreje përfundon para kohe, përbërja e njëjtë e KQZ-së dhe KZF-së, janë kompetente për zbatimin e procedurave përkitazi me zëvendësimin e mandatit respektiv.

Neni 18

Ankesat

1. Anëtari i personelit ka të drejtë të ankohet kundër vendimeve të Komisionit Zgjedhor të Fakultetit, sipas procedurave të përcaktuara në nenin 2, paragrafi 2.2 të kësaj rregulloreje.
2. Vendimi lidhur me ankesën sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të merret brenda dy ditëve të punës pas pranimit të ankesës. Vendimi në shkallën e dytë nxjerrët nga KQZ dhe është përfundimtar në procedurë administrative.
3. Anëtari i personelit me të drejtë vote për zgjedhjen e organeve përkatëse, ka të drejtë të parashtroj ankesë te Komisioni Qendror Zgjedhor, në lidhje me procedurat e zgjedhjeve.
4. Formulari përkatës, shtojca 2 do të jetë në dispozicion në secilin vendvotim në Fakultete dhe në web faqen e UHZ-së.

Neni 19

Komisioni Zgjedhor i Fakultetit

1. Komisioni Zgjedhor i Fakultetit përbëhet nga tre anëtarë:
 - 1.1. Sekretari i Fakultetit, kryesues i komisionit zgjedhor ex officio;
 - 1.2. Dy profesor të fakultetit, të nominuar nga Këshilli i Fakultetit;
2. Zgjedhja e anëtareve të KZF-së, bëhet me shumicë të votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit të Fakultetit.
3. Nëse asnjë kandidat pas votimit të parë nuk ka marrë shumicën e votave, sipas paragrafit 2 të këtij neni, në votimin e dytë garojnë katër kandidatët që kanë marrë më së shumti vota dhe zgjedhën dy kandidatët me numrin më të madh të votave të fituara nga votimi i dytë për secilën prej pozitave të parapara në paragrafin 1, nën paragrafi 1.2 të këtij neni.
4. Procesverbalet e komisionit të zgjedhjeve hartohen dhe nënshkruhen nga kryesuesi dhe anëtarët e KZF-së.
5. Mbledhjet e komisionit zgjedhor të Fakultetit thirren nga kryesuesi i KZF me pëlqimin e Komisionit Qendror Zgjedhor.

Neni 20
Data e zgjedhjeve të përgjithshme

1. Këshilli Drejtues shpallë datën e zgjedhjeve të përgjithshme në UHZ dhe në të njëjtën mbledhje zgjedh edhe anëtarët e KQZ-së, sipas dispozitave të kësaj rregulloreje. Zgjedhjet zhvillohen sipas dinamikës së përcaktuar nga KQZ-ja.
2. Në ditën e zgjedhjeve, vendvotimet duhet hapur nga ora 08:00 deri në ora 16:00.
3. Në rastet kur votuesit e përcaktuar të votojnë në atë vendvotim, kanë përfunduar votimin para orës 16, KZF-ja mund të mbyll atë vendvotim, para përfundimit të orarit të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni.
4. Komisioni Qendror Zgjedhor në bashkërendim me komisionet zgjedhore të Fakulteteve duhet të shpallin lokacionin e vendvotimeve.

Neni 21
Mënyra e votimit

1. Votuesit me të drejtë vote duhet që personalisht të hedhin votën në kutinë e votimit, në vendvotimin e Fakultetit përkatës.
2. Asnjë votues nuk ka të drejtë të votojë në më shumë se një vendvotim.

Neni 22
Mbikëqyrja e procesit zgjedhor

1. Zgjedhjet duhet të mbahen nga komisionet zgjedhore të Fakulteteve, nën mbikëqyrjen e Komisionit Qendror Zgjedhor.
2. Zgjedhjet mund të monitorohen nga institucione, organizata dhe palë tjera të interesit, në pajtim me Statutin e UHZ-së dhe legjislacionin relevant në fuqi, pas miratimit paraprak nga KQZ.

Neni 23
Procedurat e votimit dhe fletëvotimet

1. Gjatë kohës së votimit, së paku dy anëtarë të komisionit zgjedhor të Fakultetit duhet të jenë të pranishëm gjatë gjithë kohës për të siguruar mbarëvajtje të rregullt të procedurave zgjedhore.
2. Komisioni Zgjedhor i Fakultetit duhet të ndërmarrë masa procedurale për mbarëvajtjen e zgjedhjeve, si në vijim:
 - 2.1. Krijimi i një ambienti të sigurt për votim dhe ruajtje të fshehtësisë së votimit;
 - 2.2. Hapja dhe mbyllja e vendvotimeve në kohën e caktuar dhe mbajtja e vendvotimeve hapur gjatë periudhës së caktuar të zgjedhjeve;

- 2.3. Ofrimi i materialeve të nevojshme për votime;
- 2.4. Pranimin e materialeve zgjedhore nga KQZ;
- 2.5. Shënimi i procedurave të votimit në protokollin e komisionit zgjedhor;
- 2.6. Vulosja e fletëvotimeve;
- 2.7. Shënimi i numrit të fletëvotimeve dhe numërimi i votave;
- 2.8. Shënimi i rezultateve të zgjedhjeve.

Neni 24

Rrjedha e procedurës zgjedhore dhe të votimit

1. Procedura zgjedhore zhvillohet sipas ecurisë si në vijim:
 - 1.1. Komisioni i zgjedhjeve kërkon nga votuesi të identifikohet me dokument të identifikimit (letërnjoftim, pasaportë, patentë shoferi);
 - 1.2. Komisioni i zgjedhjeve kërkon nga votuesi që të identifikohet me një nga kategoritë e personelit;
 - 1.3. Komisioni i zgjedhjeve e gjen votuesin në listën e votuesve;
 - 1.4. Komisioni zgjedhor kërkon nga votuesi të nënshkruhet në listën e votuesve;
 - 1.5. Komisioni zgjedhor i jep votuesit fletëvotimet e duhura të vulosur;
 - 1.6. Votuesi voton në kabinën e votimit;
 - 1.7. Komisioni zgjedhor zëvendëson një fletëvotim sipas kërkesës nëse votuesi e ka dëmtuar atë dhe për këtë mbanë shënim zyrtarë;
 - 1.8. Votuesi e hedhë fletëvotimin në kutinë e votimit;
 - 1.9. Votuesi del nga vendvotimi menjëherë pas votimit;
 - 1.10. Komisioni zgjedhor shënon në protokoll çdo cenim të këtyre procedurave.

Neni 25

Fletëvotimi dhe vlefshmëria

1. Secili fletëvotim duhet të përmbajë emrat e të gjithë kandidatëve të cilët janë regjistruar për mandate të caktuara. Kandidatët radhiten në fletëvotim sipas alfabetit me emër dhe mbiemër.
2. Secili votues ka të drejtë të votojë në fletëvotim aq kandidatë sa edhe ka mandate në konkurrim në zgjedhjet e caktuara. Një përshkrim i përshtatshëm përkitazi me mënyrën e votimit duhet të jepet në fillim të fletëvotimit.
3. Fletëvotimet janë të vlefshme kur maksimumi i kandidatëve të paracaktuar ose më pak janë votuar.
4. Fletëvotimet nuk janë të vlefshme kur votohen më shumë kandidatë sesa maksimumi i përcaktuar, siç ceket në fletëvotim ose kur nuk votohet asnjë kandidatë ose në raste të tjera të prishjes me qëllim të fletëvotimit, sipas standardëve dhe praktikave të aplikuar nga KQZ e Republikës së Kosovës.

Neni 26
Rezultatet e zgjedhjeve dhe hedhja e shortit

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është i obliguar të shpallë rezultatet zyrtare të zgjedhjeve brenda 24 orëve pas mbylljes së vendvotimeve.
2. Në rastet kur dy ose më shumë kandidatë kanë marrë numrin e njëjtë të votave, atëherë duhet të organizohet hedhja e shortit nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që do të vendos për ndarjen përfundimtare të mandateve. Ky parim vlen për të gjitha rastet që kanë vota të barabarta në procesin e votimit, sipas kësaj rregulloreje, përveç në rastin e zgjedhjes së Dekanit.
3. Shorti duhet të organizohet brenda 48 orëve pas shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve në prani të kandidatëve. Mos prezenca e kandidatit, pas ftesës në mënyrë të rregullt dhe të sigurt nënkupton heqje dorë nga mandati.

Neni 27
Periodha e ankesave pas shpalljes së rezultateve

1. Pala e pakënaqur me rezultatin e shpallur të zgjedhjeve, ka të drejtë ankesë brenda 24 orësh.
2. Pas kalimit të periudhës kohore të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, të gjitha ankesat e dorëzuara me shkrim në lidhje me procedurat e zgjedhjeve, rezultatet e votimeve dhe mandatet e fituara do të refuzohen si të pas afatshme.
3. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendosë për të gjitha ankesat brenda periudhës prej dy ditëve të punës pas mbylljes së afatit për pranimin e ankesave.
4. Pas përfundimit të periudhës së përcaktuar në paragrafin 1 dhe 3 të këtij neni, Komisioni Qendror Zgjedhor duhet të shpallë rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 28
Vlefshmëria dhe zbatimi

1. Në rast konflikti të ndonjë dispozite të kësaj rregulloreje, me rregulloret tjera të cilat rregullojnë procedurat zgjedhore për zgjedhjet e personelit akademik dhe jo akademik në organe të ndryshme në nivel të fakultetit (Këshill të Fakultetit apo Dekan) dhe në nivel të Universitetit (anëtar i Senatit apo Rektor), vlejnjë dispozitat e Statutit dhe kësaj rregulloreje.
2. Për të gjitha çështjet lidhur me vendimet apo procedurat e kontestuara në lidhje me këtë Rregullore, vendos KQZ.

3. KQZ/KZF, janë përgjegjës për zbatimin e kësaj Rregulloreje.
4. Interpretimin autentik të kësaj rregulloreje e bën Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Neni 29
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja nr. 1080 e datës 10.05.2017, për Rregullat dhe Procedurat për Zgjedhjet e Përgjithshme në UHZ dhe ndryshimi dhe plotësimi i nenit 4 të Rregullores bazike nr. 1080-17 për zgjedhjet e përgjithshme në UHZ, numër protokollit 2993 dt.18.11.2022.

Neni 30
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i Universitetit "Haxhi Zeka".

Prof. Ass. Dr. Majlinda Belegu



Kryesuese e Këshillit Drejtues

